



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## **E K S T R A K T**

**Nga procesverbali i mbledhjes së 11-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27. 09. 2018, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10<sup>00</sup>**

### **Në mbledhje prezentuan:**

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Lulzim Rrustemi, anëtar
12. Ramiz Qeriqi, anëtar
13. Argjent Tasholli, anëtar
14. Nazmi Krasniqi, anëtar
15. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Selatin Retkoceri, anëtar
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

### **Të tjerë prezent:**

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Rasim Hasani, drejtor i DA

6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH
10. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
11. Emina Rexhiqi, drejtoreshë e DPU-së
12. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
13. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
14. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
15. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
16. Përfaqësues të OSBE-së
17. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
18. Ylber Reçica, OJQ "POLIS"
19. Përfaqësues të mediave dhe
20. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarët nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

### **REND DITE**

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 10-të e Kuvendit
2. Raporti gjashtëmuor Janar-Qershor 2018 i punës së zyrë së Kryetarit dhe drejtorateve komunale.
3. Propozim vendim mbi ridestinimin dhe transferin e mjeteve të buxhetit për vitin 2018
4. Propozim vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2019-2021
5. Propozim vendim për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit për komunën mike për fëmijë (2018-2021)
6. Propozim vendim për ndërrimin e destinimit të tokë
7. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan
8. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Lulzim Rrustemi, tha se është një agjendë shumë e ngjeshur. Është dashtë të bëhet ndarja e pikave sepse janë pika shumë të ndijshme ku ndërlidhen njëra me tjetrën buxheti, ridestini, nëse janë vetëm për të kaluar vazhdon.

Daut Azemi, Kryesues Kuvendit, tha se kemi pasur edhe tri pika të rendit të ditës por i kemi hjekur për seancën tjetër por besoj se do ta kemë në konsideratë kërkesën tuaj. Pastaj Kryesuesi, Daut Azemi, hodhi në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se me 28 vota për aprovoi rendin e ditës.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se kam dy kërkesa për mbledhjen e ardhshme, një raport – informatë për drejtorinë e bujqësisë për ndarjen e multikultivatorëve për bujqit e Lipjanit. Të dijmë se kush janë përfituesit e këtij projekti. Dhe kërkesa e dytë është një informatë nga drejtorati i arsimit për punësim, hapje dhe shpallje të konkursit para fillimit të vitit shkollor.

Ukë Kryeziu, tha se kërkoj nga drejtorati i arsimit zgjidhjen e problemit të transportit të nxënësve të Sllovisë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se dashta ta ngrisë një çështje, ku mbrëmë në një medium vendor kam dëgjuar se një fëmijë me sindrom daun është larguar nga qerdhja publike në Lipjan. Për arsye se stafi nuk po arrinë t'i ofroj kujdes të veçant. Po ashtu po kërkoj që ky fëmijë të kthehet te bashkë moshatarët e vetë.

Ramiz Qeriqi, unë kam një qështje te QKMF-ja. Në vitin e kaluar është nënshkruar një kontratë kolektive dhe nuk është zbatuar. Nuk paguhën kujdestaritë, orët e natës e tjera është mirë me na tregu pse? Po ashtu në QKMF mungojnë barnat esenciale. Po ashtu e kam përmend shumë herë punën e kazinove ku një kazino gjendet afër qerdhes. Pastaj tha se te Janjeva është mungesa e ujit na e dijmë që një projekt prej CDU-së është 500 mijë euro deshta me ditë a është duke u punuar në këtë drejtim. Po ashtu dezinfektimin nga insektet.

Egzona Bytyqi, tha se deshta me ditë se a janë marrë masa të duhura për lëndët djegëse nëpër shkolla.

Selatin Retkoceri, dashta me dijtë për pyetjet që po shtrohen a po ndërmirret diçka për aktivitetet e kërkuara nga këshillëtarët,. në projekcionin buxhetor nuk po shkohet në ndërtimin e shkollave të reja dhe është për t'u përshëndetë. Pastaj tha se disa shkolla që po bëhen nuk e dijnë se kujt po ua bëjmë pasi popullësia na ka ikur. Pastaj pavarësimi i disa shkollave të vogëla me pak nxënës nuk është mirë sepse humbet cilësia, si për shembull shkolla e Rubovcit, shkolla "Fehmi Agani" Medvec, "Nezë Buja" në Bujan, "Rexhep Akllapi" në Akllap dhe në Glllogovc të gjitha këto shkolla i kanë më pak se 180 nxënës. Çfarë cilësie mund të ketë dhe për çfarë hargjohet buxhet. Pse duhet të ketë drejtor koti nëpër këto shkolla. Është mirë që ky buxhet të hargjohet diku tjetër e jo për shkolla xhuxhe. Sivjet në Rubovc po ndërtohet një shkollë moderne por kjo është dashtë të ndërtohet më herët para 10 viteve.

Pastaj pyeti se a ka ndonjë raport të drejtoratit të bujqësisë për dëmet që janë shkaktuar në bujqësi dhe a do të ketë subvencione për ata që e punojnë tokën dhe jo për qiradhënësit.

Bashkim Budakova, ka një shqetësim nga qytetarët të bëhet kontrollimi i marketeve sepse po qarkullojnë zëra se po shitet mall me afat të skaduar.

Argjend Tasholli, unë do t'i ngris disa qështje që vijnë nga qytetarët e fshatit Gadime e Ulët që të bëhet një komision për kontrollimin e ujërave të zeza, pasi që po kanë probleme rregullisht dhe pyetja ime është se a keni planifikuar të merrni ndonjë hap që të paktën të parandalohen dëmet që po u bëhen. Tjetrën pyetje kam për trotuarin i cili është ndërtuar mbi kanalin e ujërave të zeza afër lagjës Gabrica, Dërnogllava dhe Hashani si pasoj e projektit jo të menduar mirë ujërat e zeza dalin nëpër rrugë.

Rasim Hasani, sa i përket pyetjes së Ukës për transportin e nxënësve të fshatit Sllovi shoferi e ka ndërpre punën. E kemi shpallur konkursin dhe jemi në pritje të procedurës për zgjedhjen e punëtorit të ri. Shumë shpejt do të zgjidhet ky problem. Për rastin në qerdhe ka pasur biseda në mes të prindërve dhe menaxherit të qendrës me i shiqu mundësitë më të mira të trajtimit të këtij fëmiju. Sa i përket pyetjes për lëndë djegëse. Po të gjitha shkollat janë të furnizuara me lëndë djegëse. Sa i përket pavarësimit të shkollave pajtohem me ty Selatin por ne vetëm një shkollë e kemi pavarësu dhe bashkarisht duhet të merremi me këtë problematikë nuk mundemi të bëjmë asgjë pasi ashtu i kemi gjetë.

Ramiz Qeriqi, me sa kam dëgju drejtoresha është një kimiste që nuk ka lidhje me qerdhe dhe nuk është nënë. Qysh ajo mu kujdes për fëmij kur ajo vet nuk është nënë. Është dashtë me gjetë një nënë dhe që ka profesion jo një kimiste.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se mos u lëshoni në ofendime keni kujdes.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalu në pikën e parë të rendit të ditës.

## I

### **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 10-te e Kuvendit**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Selatin Retkoceri, tha se nuk kam thënë kontabilitet aktual por akrual.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 10-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për

## **Aprovoi**

### **Ekstraktin nga mbledhja e 10-te e Kuvendit**

**Shtesë:** Ekstrakti.

## II

### **Raporti gjashtëmujor Janar-Qershor 2018 i punës së zyrë së Kryetarit dhe drejtorateve komunale**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Imri Ahmetit, Kryetar i Komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti gjashtëmujor Janar-Qershor 2018, i punës së zyrë së Kryetarit dhe drejtorateve komunale.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, tha se Kryetari na i sqaroj në pika të shkurtëra raportin është një raport i zgjëruar. Shqetësimi më i madh i qytetarëve është arsimi ku një pjesë e madhe e shkollave është keq, furnizimi me kabinete po shkon ngadal. Unë isha në shkollën e Llugaxhisë dhe e pashë që është duke u punuar dhe ka përmirësime, kisha pas dëshirë të veprohet në të njejtën mënyrë edhe në shkollat tjera. Kërkoj të veprohet në të gjitha shkollat me kabinete edhe teknologji për t'u avansuar procesi edukativo arsimor.

Shëndetësinë e kam vizituar m'u duk mirë por sa punohet aty, sa u shërbehet qytetarëve edhe në analiza edhe në barna esenciale.

Infrastruktura sa i përket rrugës Lipjan-Magurë investim nga qeveria është duke u shtruar por është shumë keq. Kjo rrugë nuk ka cilësi të mirë.

Rruga te udhëkryqit Lipjan-Janjevë është investim nga qeveria më në fund po besoj se do të bëhet diçka.

USAID-i e ka zgjedhur komunën e Lipjanit si komunën më të mirë dhe këtë duhet përshëndetur por pasi që jemi zgjedhur komunë e parë duhet pa se qfar mund të përfitojmë.

DEMOS-i dhe ministria e ka renditur lartë komunën tonë edhe kjo është për t'u përshëndetur, edhe këtu presim përfitime.

Vendimet e gjykatave po e marrim një pjesë të madhe të buxhetit dhe kjo ndikon negativisht është mirë që në të ardhmen mos të kemi shpenzime për vendimet gjyqësore.

Çka po bëhet me zonat industriale me fabrikat dhe Kërqevën është mirë me pas një raport.

Fabrika në Banullë e kërpudhave duhet me ditë se çka po bëhet me to.

Kulturë, Rini dhe Sport, terrenet sportive është mirë që çdo vend ta ketë nga një fushë sportive por duhet filluar edhe me terene të mëdha sportive.

Urbanizëm a janë hartuar hartat zonale dhe kur fillon realizimi. Objektet pa leje, legalizimi çka po ndodh me këto.

Lulzim Rustemi, tha se zyra e protokolit evidenton takimet me qytetarët me delegacionet por nuk kemi ndonjë plan pune nuk kemi ndonjë saktësim se çka del nga këto takime dhe çka fiton Komuna e Lipjanit. Përfaqësuesit e zyrës ligjore i duhet një bashkëpunim më i mirë me Kuvendin dhe ekzekutivin. Sa i përket sektorit për marrëdhënie

me publikun këtu është mirë, por duhet të ketë hapsirë më tepër. Këtu duhet t'i ipet një hapsirë opozitës pasi që opozita nuk ka shumë hapsirë në web fagen e komunës. Auditori i brendshëm obligohet që planin e punës ta dërgoj në KPF, mirëpo këtë ende nuk e bën. Sektori pronësor juridik, në Lipjan dihet që ka shumë uzurpime dhe ende nuk është bërë për këtë qështje. Sektori i administratës ka përmirësime por zyret e ofiqarisë jashtë komunës nuk janë në nivelin e duhur. Te buxheti ka vërejtje duhet të ishte më mirë. Te urbanizmi ka shumë punë është një kaos urbanistik ku kemi shumë objekt ndërtimore pa leje, ku ke shumë ndërtesa pa parkingje dhe pa shkallë emërgjente. Te shërbimet publike kemi projekte që janë të nivelit shumë të ulët. Nuk ka mirëmbajtje të parqeve as të rrugëve. Te bujqësia nuk është analizu mirë. Nuk ka ndonjë raport se sa dëme janë shkaktu dhe duhet t'ju ndihmohet më shumë. Pasi që me sera është ndihmë e vogël. Në përgjithësi ky raport ka vërejtje nuk janë paraqitur sfidat dhe si i tillë nuk ka nevojë për ndryshime.

Nazmi Krasniqi,sa i përket raportit po shihet se është punu, por në këtë raport nuk janë paraqitur edhe të metat. Po ndalem te arsimi dikun 32 nxënës nuk kanë marrë fare pjesë në testin e arritshmerisë apo semimaturës.Po ashtu 110 nxënës kanë mbetur pa u notuar në shkollën "Adem Gllavica". Edhe në shkolla tjera diku afër 130-140 nxënës kanë mbetur pa notuar është dashtë të ketë një arsye për këta nxënës.

Cilësia në arsim është dashtë të jetë në nivel më të lartë. Po ashtu mungon niveli i kuadrit profesional. Cilësia në arsim nuk është e mirë.

Bashkim Budakova, tha se lidhur me këtë raport te zyra e Kryetarit dhe drejtorateve komunale ky raport nuk përputhet me realitetin.Pasi që vijë nga sfera e arsimit mua më shqetëson një fakt ku në drejtimin e bujqësisë nga 46 nxënës të gjithë janë me notë negative dhe kjo është shqetësuese. Po ashtu te drejtorati i bujqësisë nuk e kemi një raport të dëmeve dhe vërshimeve.

Hyra Bytyçi, në emër të grupit parlamentar të LDK-së duke u bazuar në të dhënat e këtij raporti nga ky raport e vlerësojmë si raport pozitiv. Si rezultat i transparencës i llogaridhënies nga indeksi i konkurshmerisë nga USAID-it jemi vlerësuar lart si komunë dhe pritet investime të reja. Po ashtu për performancën e lartë nga DEMOS-i dhe Ministria e administratës publike. Me ç'rast komunës tonë i ofron mundësi për kredi të buta. Në institucione të larta dhe në banka si dhe në qeveri. Si rezultat i performancës së lartë komuna jonë ka fituar një grant prej 189 mijë euro. Sa i përket planifikimit shihet se buxheti është alokuar në mënyrë të kënaqshme,dhe ne si grup pralamentar i LDK-së e përkrahim dhe e inkurajojmë për punën të mëtutjeshme.

Lulzim Rrustemi,te testi i arritshmërisë dhe testi i maturës, nuk kemi arritë nivel të mirë Gjimnazi ka një nivel të mirë dhe shkolla profesionale, ndërsa shkolla në Shalë jo e kënaqshme, ku te na gjysëm vjetori i parë ka sukses të dobët ndërsa, gjysëm vjetori i dytë nivel të kënaqshëm. Ku nuk kemi një vlerësim real,duhet me ju tregu mësimdhënësve se nuk kanë nevojë me kanë dorëlibër po duhet të jenë sa më real. 271 nxënës janë të pa notuar kemi mbi 136000 mungesa të gjitha këto duhet me u vlerësu. Në arsim duhet të punojmë më shumë duhet të dijmë sa profesor kemi jo adekuat.Te sheshi "Adem Jashari" është mirë me intervenu me i ngjitë do drita te busti se vetem aty ka mbet terr.

Shkelzen Bislimi,po lidhna me arsimin po e dijmë që gjendja o keq po u dashte disa vite ma heret me marr masa dikush. Për arsimin me arritë një shkallë të duhur një cilësi të duhur.

Imri Ahmeti,ato qe u pëmendën nga Selatini dhe Luli vlen të dskutohen disa prej tyre.Sa i përket pronave komunale ato kane qenë ma heret në kuvend por do t'i bijmë përsëri në kuvend dhe se bashku me juve t'ju ipen atyre qe punojnë. Ato 270 mijë euro që janë marrë nga gjykatat janë kryesisht landë të arsimit, për punëtor të arsimit.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalu në pikën tjetër të rendit të ditës.

### III

#### **Propozim vendim mbi ridestinimin dhe transferin e mjeteve te buxhetit per vitin**

**2018**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadnit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, tha se lidhur me ato teprica që po i ridestinojmë, renovimi i objekteve të vjetra në rregull. Ne vazhdim pyeti se asfaltimi a është projekt i veçant, rruga Dobrajë e Vogël-Medvec a është një rrugë strategjike, mos është dashtë këto mjete të investohen diku tjetër.

Kolektori i ujërave të zeza në fshatin Leletiq në rregull të kaloj.

Pastaj tha se dëmet nga reshjet në fshatin Gadime nga vërshimet mirë të sanohen.

Sa i përket mjeteve në bujqësi nuk po më vjen mirë që mjetet me tepru.

Sa i përket kulturës dhe zyrës së Kryetarit është mirë që janë ridestinu mjetet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket tepricës kanë tepru 27000 € dhe ne është dashtë me i ridestinu në disa projekte për shkak të procedurave nuk kemi mundur me i planifiku kemi vendos që këto mjete t'i ridestinojmë për disa projekte të vogla.

Sa i përket rrugës Dobrajë-Medvec në pyetjen e juaj Selatin kemi vendos për këtë rrugë pasi që me devijimin e rrugës që është bërë nga Feronikeli këto fshatra janë ofru dhe kjo rrugë u nevoitet Dobrajës së Madhe dhe Dobrajës së Vogël.

Riparimi i dëmeve nga reshjet në Sllovi, Smallushë, Gadime dhe Qallapek plus kanalizimet të cilat kanë qenë të evidentuara.

Ujërat e zeza të Leletiqit, Blinajës dhe Magurës do t'i qojmë në impiantin e Qylagës, kurse në vitin e ardhshëm nëpër mes gypave të Qylagës në kolektorin e Dobrajës dhe me lidh me kolektorin që do të qojmë rreth Sitnicës.

Rrethojat rreth komune duhet me u rregullu po ashtu barakat duhet me u largu prej aty për shkak të kushteve të cilat janë jo të mira dhe ne nga ato baraka ata punëtorë me i vendos te objektet e reja që janë në pronë të komunës.

Mjetet e QKMF-së Selatin në QKMF janë marrë në QKMF kanë mbetë.

Për renovimin e banjove në shkollën "Ismail Luma" po propozoj 8 mijë euro me u hjekë nga dëmet dhe vërshimet dhe të barten për shkollën "Ismail Luma".

Ukë Kryeziu, ne e mirëpresim dhe e përkrahim këtë ridestitim të mjeteve për shkak të kësaj periudhe kohore. Pastaj pyeti për riparimin e dëmeve në fshatin Sllovi, Smallushë dhe Gadime për hapjen e lumenjëve dhe prrockave.

Egzona Bytyqi, unë personalisht e falenderoj qeverisjen komunale për ridestinimin e mjeteve financiare për ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza të fshatit Qylagë pasi ka qenë kërkesë e kahmotëshme e bashkëvendasve të mi. Këto projekte me të vërtetë janë për t'u përshëndetur.

Lulzim Rrustemi, pajtohem për ndarjen e 8 mijë eurove për shkollën "Ismail Luma", por unë kam një propozim që për shkollën e Akllapit të ndahen mjete për renovimin e nyjeve sanitare pasi që janë të pa përdorëshme.

Afrim Miftari, edhe ne si grup e përkrahim ridestinimin por kam një kërkesë të shikohet mundësia që të ndahet një pjesë e mjeteve për mirëmbajtjen e kanalizimit në fshatin Gadime.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se të gjitha projektet janë të specifikuara ku do të punohet. Pajtohem me Lulin, por nëse dakordohet Kuvendi kam një propozim që të ndahen 9500€ për renovimin e banjove në shkollën "Ismajl Luma" në Lipjan dhe "Rexhep Akllapi" në Akllap.

Megjë diskutime të tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për, aprovoi këtë:

**VENDIM**  
**MBI RIDESTINIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE TË BUXHETIT PËR VITIN 2018**

**Neni 1**

Me këtë Vendim Ridestinohen dhe Transferohen mjetet nga buxheti në kategoritë Mallra dhe Sherbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Investime Kapitale.

**Neni 2**

**FONDI BURIMOR (10)**

**INVESTIME KAPITALE :**

**Mjetet e mbetura nga projektet :**

**Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

|                                                                                                                                  |                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 40181 ASFALTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN AKLLAP.<br>10/613/18163/31230/40181/0451                                                    | 732.52           |
| 40182 ASFALTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN SLLOVI.<br>10/613/18163/31230/40182/0451                                                    | 11,251.69        |
| 41932 NDËRTIMI I LAPIDARIT PËR KOMANDANTIN LEGJENDAR ADEM JASHARI<br>10/613/18163/31125/41932/0451                               | 405.00           |
| 43088 ASFALTIMI I RRUGES BABUSH-CERNILLË<br>10/613/18163/31230/43088/0451                                                        | 15,646.85        |
| 45449 HAPJA DHE ZGJERIMI I LUMENJEVE NË FSHATRA<br>10/613/18163/32100/45449/0451                                                 | 7,244.75         |
| 45453 NDERTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT FEKAL NË FSHATI LELETIQ<br>10/613/18163/31250/45453/0451                                 | 1,848.85         |
| 45467 ASFALTIMI I RRUGICAVE NË LAGJET E FSHATIT GADIME E EPËRME<br>10/613/18163/31230/45467/0451                                 | 794.95           |
| 47366 INSALIMI I KAMERAVE NË RRUGËT E QYTETIT TË LIPJANIT<br>10/613/18163/31690/47366/0451                                       | 800.00           |
| 47369 ASFALTIMI I RRUGËVE NË GRACKË TË VJETËR DHE RRUGËS GRACKË E VJETËR DERI TE RRUGA KRAISHTË<br>10/613/18163/31230/47366/0451 | 16,076.46        |
| 47373 ASFALTIMI I RRUGËS LUFTËTARËT E LIRISË NË BABUSH<br>10/613/18163/31230/47373/0451                                          | 17,310.90        |
| 47374 NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË LAGJEN E RE NË BABUSH<br>10/613/18163/31230/47374/0451                                           | 3,009.22         |
| 89228 ASFALTIMI I RRUGËVE BRENDA NË QYTETIN E LIPJANIT<br>10/613/18163/31230/89228/0451                                          | 23,000.00        |
| Gjithsej:                                                                                                                        | <b>98,121.19</b> |

**Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami Arsim dhe Shkence kodi i programit (93060):**

|                                                                                                                                                        |                 |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 47382 FURNIZ. DHE MONTIMI I KALDAJES,RIPARIMET E NGROHJEVE QENDRORE NË SHKOLLAT ISMAJL LUMA LIPJAN, KOJSKË DHE GADIME<br>10/613/93060/31270/47382/0912 | 3,383.25        |
| 47384 KABINETET PËR SHKOLLA(KIMI,BIOLOGJI,FIZIKË,TIK,ETJ)FILLORE DHE TË MESME<br>10/613/93060/31690/47384/0912                                         | 786.80          |
| Gjithsej:                                                                                                                                              | <b>4,170.05</b> |

**Totali nga Granti Qeveritar ne Kategorine Investime Kapitale (10)..... 102,291.24 €**

**Mjetet e mbetura nga projektet nga fondi burimor (10) barten në këto projekte:****Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

|                                                                                                                                              |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| - RRËNIMI I OBJEKTEVE TË VJETRA KOMUNALE DHE NDËRTIMI I RRETHOJËS NË OBORRIN E KOMUNËS (PROJEKT I RI)                                        | 25,000.00         |
| - ASFALTIMI I RRUGËS MEDVEC-DOBRAJE E VOGËL DHE RRUGA NË FSHATIN DOBRAJË E VOGËL QË LIDH RRUGËT SLLAPUZHAN DHE RRUGËN JASHARI (PROJEKT I RI) | 43,000.00         |
| - KOLEKTORI I UJËRAVE TE ZEZA LELETIQ, BLINAJË,QYLAGË DHE REHABILITIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT NË MAGURE (PROJEKT I RI)                     | 30,584.24         |
| - 45080 ASFALTIMI I RRUGEVE NE LAGJET E FSHATIT DOBRAJË                                                                                      | 3,707.00          |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                                                                             | <b>102,291.24</b> |

**Totali i bartur 10)..... 102,291.24 €**

**FONDI BURIMOR (21)****INVESTIME KAPITALE :****Mjetet e mbetura nga projektet:****Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

|                                                                                                     |                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| 45409 ASFALTIMI I RRUGES QE LIDHE FSHATRAT DOBRAJE E VOGEL-MAGURË<br>21/613/18163/31230/45409/0451  | 22,611.89         |
| 45438 NDERTIMI I TROTUARVE ME NDRIQIM PUBLIK NE FSHATIN SLLLOVI<br>21/613/18163/31240/45438/0451    | 4,996.76          |
| 45453 NDERTIMI I RRJETIT TE KANALIZIMIT FEKAL FSHATI LELETI<br>21/613/18163/31250/45453/0451        | 25,000.00         |
| 47368 FASADIMI I OBJEKTEVE NË QYTET<br>21/613/18163/31270/47368/0451                                | 57,863.56         |
| 47376 NDËRTIMI I TROTUAREVE ME NDRIQIM PUBLIK NË BANULL RRUGA LIVA<br>21/613/18163/31240/47376/0451 | 15,952.59         |
| <b>Gjithësejt:</b>                                                                                  | <b>126,424.80</b> |

**Shendetesia dhe Mireqenia Sociale( 720),Nënprogrami i Sherbimet e Kujdesit Primar Shendesor (73200) nga projektet:**

|                                                                                 |                 |
|---------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 47452 BLERJA DHE INSTALIMI I KALLDAJES NE QKMF<br>21/613/73200/31690/47452/0721 | 4,812.00        |
| 47453 RENOVIMI I STREHIMORES SË RE<br>21/613/73200/31270/47453/07               | 4,696.00        |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                | <b>9,508.00</b> |

**Kulture,Rini dhe Sport (850),Nënprogrami i Kultures, Rinise dhe Sport kodit i programit (85003):**

|                                                                                                     |                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 47456 BLERJA I INVENTARIT PËR FUNKSIONALIZIMIN E QENDRES RINORE NË<br>21/613/85003/31620/47456/0820 | <b>618.00</b>   |
| 47461 BLERJA E INVENTARIT PËR ARKIVEN NE BIBLIOTEKEN E QYTETIT<br>21/613/85003/31620/47461/0820     | 2,431.00        |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                                    | <b>3,049.00</b> |

**Arsim dhe Shkencë ( 920),Nënprogrami i Arsimit Fillor (93060) nga projekti**

|                                                                                                      |          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| 47383 RREGULLIMI I INFRASTRUKTURES NË PARALELEN E NDARË GLLAVIC-MAREVC 21/613/93060/31270/47383/0912 | 2,157.15 |
| 47457 NDERTIMI I SHKOLLES NE FSHATIN RUBOVC FAZA II                                                  | 5,123.89 |

|                               |                 |
|-------------------------------|-----------------|
| 21/613/93060/31121/47457/0912 |                 |
| <b>Gjithsej:</b>              | <b>7,281.04</b> |

**Totali nga te hyrat vetanake (21) ne Kategorine Investime Kapitale .....146,262.84€**

**Mjetet e mbetura nga projektet nga te hyrat vetanake (21) barten në keto projekte:**

**Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

|                                                                                                                                         |                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| - KOLEKTORI I UJRAVE TE ZEZA LELETIQ, BLINAJË,QYLAGË DHE REHABILITIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT NË MAGURE (PROJEKT I RI)                 | 30,415.76         |
| - RIPARIMI I DËMEVE NË INFRASTRUKTURË NË FSHATRAT GADIME E EPËRME DHE ULËT,VRELLËE GADIMES,SLLOVI,SMALLUSHË DHE QALLAPEK (PROJEKT I RI) | 96,839.08         |
| <b>Gjithësejt:</b>                                                                                                                      | <b>127,254.84</b> |

**Shendetesia dhe Mireqenia Sociale( 720),Nënprogrami i Sherbimet e Kujdesit Primar Shendesor (73200) nga projekti:**

|                                                                                      |                 |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| - RENOVIMI I NYJEVE SANITARE DHE KANALIZIMI NË QKMF<br>21/613/73200/31690/47452/0721 | 9,508.00        |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                     | <b>9,508.00</b> |

**Arsim dhe Shkencë ( 920),Nënprogrami i Arsimit Fillor (93060) në projektin**

|                                                                                               |                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| RENOVIMI I BANJOVE DHE NYJEVE SANITARE NË SHF “ISMAIL LUMA” DHE “REXHEP AKLLAP” –PROJEKT I RI | 9,500.00        |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                              | <b>9,500.00</b> |

**Totali bartur (21) ne Kategorine Investime Kapitale ..... 146,262.42.€**

**FONDI BURIMOR (22)**

**INVESTIME KAPITALE :**

**Mjetet e mbetura nga projektet:**

**Tabela nr. Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

|                                                                                  |                 |
|----------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| 41934 NDËR.LAPIDARIT DËSHMORIN E KOMBIT ARSIM ZEQRIRI<br>22/613/31125/41934/0451 | 2,000.00        |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                 | <b>2,000.00</b> |

**Tabela nr. Arsim dhe Shkencë ( 920),Nënprogrami i Arsimit Fillor (93060) nga projekti**

|                                                                                                     |                  |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 41963 RREGULLIMI INFRASTRUKTURES OBORRIT SH.F.BREGU I ZI SHFMIRENË<br>22/613/93060/31270/41963/0912 | 19498.68         |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                                    | <b>19,498.68</b> |

**Totali nga te hyrat vetanake (22) në Kategorine Investime Kapitale .....21,498.68€**

**Mjetet e mbetura nga projektet nga te hyrat vetanake (22) barten në kë projekt:**

**Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)**

|                                                                                                                                         |                  |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| - RIPARIMI I DËMEVE NË INFRASTRUKTURË NË FSHATRAT GADIME E EPËRME DHE ULËT,VRELLËE GADIMES,SLLOVI,SMALLUSHË DHE QALLAPEK (PROJEKT I RI) | 21,498.68        |
| <b>Gjithsej:</b>                                                                                                                        | <b>21,498.68</b> |

**Totali bartur nga fondet (10), (21) dhe (22)..... 270,052.76€**

## Mallra dhe sherbime

### Mallra dhe sherbimet (21) për ridestininim/transfer

| Organizata Buxhetore: Lipjan (613)       | Buxheti i aprovuar 2018 | Kodi I kategorisë ekonomike | Ridestininim/Transferi |
|------------------------------------------|-------------------------|-----------------------------|------------------------|
| Shërbime Publike.MCE(180)                | 42,600.00               | 130                         | (15,000.00)            |
| Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik (48003) | 34,900.00               | 130                         | (5,000.00)             |
| Sherbimet Kulturore (85003)              | 35,000.00               | 130                         | (5,000.00)             |
| Arsim Fillor (93060)                     | 30,000.00               | 130                         | (5,000.00)             |
| Arsimi I mesem (94260)                   | 10,000.00               | 130                         | (2,000.00)             |
|                                          |                         |                             | <b>(32,000.00)</b>     |

### Mjetet nga Mallrat dhe Sherbimet-fondi burimor (21) transferohen

| Organizata Buxhetore: Lipjan (613)            | Buxheti I aprovuar 2018 | Kodi i kategorisë ekonomike | Transferi/       |
|-----------------------------------------------|-------------------------|-----------------------------|------------------|
| Sherbimet e Kujdesit Primar Shëndesor (73200) | 10,000.00               | 130                         | 15,000.00        |
| <b>Totali:</b>                                |                         |                             | <b>15,000.00</b> |

### Mjetet nga Mallrat dhe Sherbimet-fondi burimor (21) ridestinoen në Sherbime Komunale

| Organizata Buxhetore: Lipjan (613) | Buxheti I aprovuar 2018 | Kodi i kategorisë ekonomike | Ridestিনি        |
|------------------------------------|-------------------------|-----------------------------|------------------|
| Shërbime Publike.MCE(180)          | 23,000.00               | 132                         | 5,000.00         |
| Sherbimet Kulturore (85003)        | 5000.00                 | 132                         | 5,000.00         |
| Arsim Fillor (93060)               | 5000.00                 | 132                         | 5,000.00         |
| Arsimi I mesem (94260)             | 2000.00                 | 132                         | 2,000.00         |
| <b>Totali:</b>                     |                         |                             | <b>17,000.00</b> |

### Subvencionet dhe transferet (21) për transfer

| Organizata Buxhetore: Lipjan (613) | Buxheti I aprovuar 2018 | Kodi i nënkategorisë ekonomike | Transferi          |
|------------------------------------|-------------------------|--------------------------------|--------------------|
| Bujqësia (47003)                   | 130,000.00              | 200                            | (19,500.00)        |
| <b>Totali:</b>                     |                         |                                | <b>(19,500.00)</b> |

### Mjetet nga Subvencionet dhe transferet (21) transferohen

| Organizata Buxhetore: Lipjan (613) | Buxheti I aprovuar 2018 | Kodi i nënkategorisë ekonomike | Transferi        |
|------------------------------------|-------------------------|--------------------------------|------------------|
| Zyra e kryetarit (16003)           | 107,067.00              | 200                            | 9,500.00         |
| Sherbime Kulturore (85003)         | 70,000.00               | 200                            | 10,000.00        |
| <b>Totali:</b>                     |                         |                                | <b>19,500.00</b> |

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

**Shtesë:** Vendimi.

Kryesuesi dha pauzë nga ora 12,<sup>00</sup> deri në ora 13,<sup>00</sup>

### IV

#### **Propozim vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2019-2021**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, kur analizon këtë propozim e sheh që vazhdon avazi i vjetër e asfalteve ku vitet e kaluara janë bërë pa mbikëqyrje profesionale ose nëse ka pasur mbikëqyrje dikush duhet të jep llogari për nivelin e dobët të tyre. Nëse e shikon në këtë buxhet sa të holla janë ndarë për laborator e kabinete shihet se është një shumë shumë e vogël. Ndërsa ekzekutivi e ka planifikuar një qerdhe në qytet, ndërsa për neve që jetojmë nëpër fshatra a nuk kemi nevojë për qerdhe që t'ua mundësoj gjinisë femrnore punësimin.

Në shëndetësi ndahën vetëm 410 mijë euro për 3 vite ndërsa populli i jonë detyrohet të blejë shiringa, ku në QKMF mungojnë barrnat esenciale. Po ashtu nuk kemi kontrollë të barnatoreve të atyre që punojnë të dieleve dhe gjatë ditëve tjera. Në QKMF kryhen vetëm disa prej analizave, ndërsa 80% të tyre duhet t'ju drejtohem i ordinancave private. Ndërsa sa i përket bujqësisë bujku ende vazhdon të shkelet pasi ska buxhet që t'ju ndihmoj. Në përgjithësi shihet se ky buxhet është i shpërndarë në asfalte.

Egzona Fazlija, Nisma Social Demokrate e ka analizu dhe nuk e shohim të nevojëshme që rruga Torinë-Ribar të shtrohet pasi që asnjërin nga këto fshatra nuk i lidh me Lipjanin po ashtu kam një pyetje te rruga "Shqipëria" dhe rruga "Hajredin Bajrami" qka do të bëhet me këto mjete të cilat janë ndarë, ne si parti jemi kundër këtij buxheti.

Ramiz Qeriqi, kam një ankesë pse Lumi Janjeva është tërheq pasi që ka qenë në projekt kur dihet se aty kalojnë nxënësit e shkollave dhe hatri i nxënësve është dashtë të rregullohet.

Selatin Retkoceri, para vetes kemi një dokument shumë të rëndësishëm buxhetin e komunës, ku shumica e tij shkon paga dhe mëditje dhe mallëra dhe shërbime. Nuk shihet që ka shenja që qeveria do të na ndihmoj në përjashtim të rrugës për Banullë. Buxhetin të cilin e kemi po të investoje vetëm në një fshatë nuk do të ishte i mjaftueshëm por ne kemi përgjegjësi para qytetarëve, para punëtorëve të administratës, shëndetësisë, arsimit etj. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve pajtohem i pasi që ato prishje duhet të rregullohen, kanalizimit duhet t'i kushtohet shumë rëndësi. Sa i përket asfaltimit të rrugës Torinë-Ribar nuk jemi kundër por deri sa kemi problem me arsim, shëndetësi duhet të kemi kujdes. Sa i përket objektit të ri të komunës është e mirë dhe duhet të ketë donatorë. Fushat e sportit të vazhdohet në secilin fshat me nga një fushë të tillë. Për fund kërkoj të kemi kujdes se kemi përgjegjësi para qytetarëve dhe të jepim vërejtjet çka duhet me u përmirësu.

Ukë Kryeziu, tha sot kemi një dokument shumë të rëndësishëm të komunës për vitin 2019. Po kur shikon këtë projeksion buxhetor len hapsirë për të dëshiruar. Te investimet kapitale kemi mundësi levizje të projekteve dhe mundemi me e ndryshu.

Te investimet kapitale janë projekte minore që nuk mund të thonë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës sonë. Te ujësjellësi a e kemi zgjidhur problemin me ujë të pishëm në të gjitha fshatrat. Shumica e qytetarëve të Lipjanit nuk kanë ujë të pijshëm dhe komuna është dashtë me reflektu. Është dashtë të zgjerohet rrjeti i ujësjellësit dhe të kryhet njëherë e përgjithmon ky problem.

Kanalizimi është dashtë të zgjerohet.

Mjetet e dedikuara për shpronësim duhet ta dijmë koston sepse ne nuk e dijmë se cilat prona po shpronësohen dhe sa do t'i kushtojë komunës.

Asfaltimi i rrugëve Ribar i Madh – Torinë, prap asfaltimi i rrugës Torin-Ribar i Vogël, asfaltimi i rrugës Gadime-Gllavicë, asfaltimi i rrugëve Sllovi, Smallushë, Gadime është një kosto e madhe. Sa po shfrytëzohen këto projekte nuk tregojnë zhvillim ekonomik të të mirëfillt të komunës së Lipjanit.

Duhet të ndërprehet asfaltimi i rrugëve jo publike, rrugët të cilat nuk kanë emër.

Në shëndetësi e përgëzoj drejtoreshën shihet se është një hap tutje por duhet patur kujdes ku po investohet.

Janë 4 ultrazëra ku njëri funksionon e tre të tjerë nuk funksionojnë sepse nuk ka kuadër të mjeftueshëm me i përdor këta ultrazëra. Të shkarkohet rrjeti i laboratorëve në QKMF pasi që në Janjevë, Magure, Shalë nuk janë me aparaturë të mjaftueshme. Po ashtu kërkoj nga drejtoresha edhe në Sllovi të investohet në laborator, pasi ka banorë të mjaftueshëm.

Investimet në arsim duhet të rriten unë e përgëzoj Kryetarin, drejtorinë për investim në shkollë.

Kulturë, Rini dhe Sport investimi fillon dhe mbaron me fusha sportive. Në Sllovi kemi dy fusha por nuk po shfrytëzohen, andaj propozoj që mos derdhen mjete dhe fushat të bëhen afër shkollës. Nërsa për mirëmbajtje e objekteve me rëndësi të veçant për kulturë nuk janë parapa mjete. Po ashtu për rrugën e Sllovisë nuk janë parapa mjete për shenjëzimin, vendosjen e tabelave pasi që është një rrugë e rrezikshme dhe ka kthesa.

Lulzim Rustemi, natyrisht jemi para një dokumenti të rëndësishëm për qytetarët e komunës së Lipjanit. Buxheti paraprakisht i prin disa diskutimeve, debate, dëgjime publike një kohë të gjatë me qytetarë, shoqërinë civile, grupe të interesit dhe me ekzekutivin legjislativin për të ardhur te një masë e dëshirueshme e prioriteteve të nevojshme për qytetarët e komunës së Lipjanit. Te korniza afatmesme buxhetore 2019-2020 për vitin 2019 janë parapa 35 projekte, ku 19 projekte janë të parapara. Në debate që i kemi pas me organizatën Polis kemi parë se kërkesat e qytetarëve nuk merren parasysh dhe e dyta ato ndryshohen. Nëse në një dëgjim publik vijnë qytetarët dhe ne ju themi se këto projekte i keni në vitin e ardhshëm e nëse vitin e ardhshëm nuk janë ato projekte qytetarët më nuk do të vijnë në dëgjime publike. Unë i kuptoj ndryshimet që mund të bëhen por jo kaq ndryshime të mëdha. Kemi edhe projekte ku është rritur vlera. Kemi edhe rritje të shpenzimeve të infrastrukturës ku janë cekur 70 mijë euro për rrjet të kanalizimit, është mirë të ceket se në cilat fshatra do të bëhet. Te arsimi kemi ramje të investimeve në këtë vit, është mirë që komuna me i rritë investimet në arsim, shëndetësi dhe bujqësi. Te arsimi ka nevojë për investime për kabinete, laborator dhe për disa shkolla.

Te renovimi i shkollës në Krojmir nyjet sanitare janë në gjendje të vështirë nuk mjafton kjo shumë e parapame. Për të gjitha investimet kapitale për vitin 2019 nuk janë bërë investime proporcionale për të gjitha fshatrat. Për ujin e pijshëm në Topliqan, Akllap, Vrellë e Gadimes ende nuk kanë ujë të pishëm.

Ne si grup parlamentar mendojmë se në këtë buxhet është dashtë të bëhet shumë më tepër. Ajo që më së shumeti i mungon Lipjanit është uji i pijshëm që nuk është parapa asnjë cent në këtë buxhet. Sa i përket qerdheve është dashtë të ketë më shumë qerdhe në disa lokalitete të komunës së Lipjanit. Po ashtu është dashtë rregullimi i hapsirave gjelbëruese nëpër fshatrat e komunës së Lipjanit. Sa i përket bujqësisë është ndarë një buxhet por është shumë pak është dashtë të investohet më tepër. Për këto vërejtje të mëdha të buxhetit na kishim planifiku ndryshe si PDK, ne nuk e japim votën për këtë buxhet për vitin 2019.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se mirë e ka Luli buxheti ka kaluar nëpër disa debate, dëgjime publike këta delegatë që po e shoh sallën plot sot nuk i kam parë edhe në takimet kur janë mbajtur dëgjimet publike.

Sa i përket buxhetit dhe investimeve një pjesë të projekteve unë i kam propozuar por pjesën tjetër të investimeve është kërkesë e qytetarëve.

Te ujësjellësi nuk kemi të dedikuara mjete është e vërtetë por këtë e din Selatini se kjo përgjegjësi është kompanisë së ujsjellësit e ne mund të bashkëfinancojmë. Ministria e planifikimit hapsinor e ka shpallë një tender për Vrellën e Gadimes për ujësjellës për këtë ne nuk kemi planifikuar, ndërsa me CDI-në jemi në prag të marrëveshjes që do të fillon implementimi i ujësjellësit për këto fshatra: Topliqan, Bujan, Ribar i Madh, Kraishtë dhe Bregu i Zi.

Në javën e ardhshme do të nënshkruhet një marrëveshje bashkëfinancimi me ujësjellësin rajonal për vendosjen e orë matësve për fshatin Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Gllanicë dhe Torinë.

Shkollën fillore në Lipjan qëllimisht nuk e kemi përfshi në projekt sepe kemi me përfshi në nivel të ministrisë se ka nevojë Lipjani për një shkollë. Shumë shpejt do të vijë në Kuvend për vendosjen e lokacionit se ku do të bëhet kjo shkollë. Qerdhet janë hjekur pse janë hjekur, kemi pasur një ankesë nga OSHP se qerdhet të ndërtohen me partneritet publiko privat.

Sa i përket pyetjes së Ukës se Torina është bërë një qendër po i përgjigjem kështu se në Torinë përveq rrugës kryesore asnjë rrugë apo rrugicë nuk është asfaltuar as shkollë nuk ka ende.

Për fondin e IPAS, ne jemi nga komunat që kemi apliku për këtë grant. Ne kemi qënë ndër komunat e para dhe në qoftë se do të fitohet ky grant ne do të ndërtojmë objektin e komunës se re me ato mjete, por nëse jo atëherë e kemi të planifikuar në buxhet.

Albulena Kelmendi, tha se mos votimi i buxhetit nuk është mirë të mos votohet vetëm se jemi opozitë nëse del se buxheti gjithçka është në rregull. Në bazë të asaj që e thanë parafulësit z.Rrustemi, z. Retkoceri dhe Shkelzeni vërejtjet e tyre ishin me arsye po kishte qenë mirë të kishin këtë elan edhe atëher kur e kanë pasur buxhetin në dorë. Mos investimi nëpër shkolla e kuptoj se janë nevojat e mëdha dhe e di që se në shumë shkolla gjendja është sikur në shkollën "Ismail Luma". Sa i përket qendrave reaktive nevojat për fushat sportive është në rregull por rinia ka nevojë për punësim, shkollim e tani ideja për me luajt është edhe më mirë. Unë jam kundër këtij buxheti.

Nazmi Krasniqi, tha se ne Lipjan ka nevojë edhe për një shkollë fillore. Pasi kemi vetëm dy shkolla fillore, ku në shkollën "Vllëzërit Frashëri" kemi telashe me nxënës, ku në një klasë janë më tepër se 40 nxënës dhe nuk e di çfarë mesimi mund të zhvillohet aty. Shumë më mirë është të investohet në shkolla. Unë jam i mendimit se është mirë të tregu ku ka qenë të ndërtohet një shkollë e jo nëpër lagje. Pasi që nxënësit nuk shkojnë në ato shkolla.

Imri Ahmeti, sa i përket shkollave fillore ka nevojë më u ndërtu. Numri i nxënësve është shumë i madh por duhet me gjetë mundësit e pronës edhe mundësit financiare.

Ganimete Qeriqi, kam një kërkesë pasi që t'i shtroni të gjitha rrugët ta shtroni edhe rrugën "Mbretresha Teutë" që ka dalje në dy rrugët kryesore.

Nazmi Krasniqi, unë kam një mendim sikur të ndërtohet një shkollë te rruga te tregu i gjelbërt. Shkollat në Lipjan shkarkohen për një periudhë të gjatë dhe mbahet mësim tërë ditë, prej klases së parë deri të gjashtë edhe prej klasëve të gjashta deri të nëntat.

Hyra Bytyqi, planifikimi i buxhetit është një dokument i rëndësishëm ku bëhet alokimi i mjeteve sipas programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike, planifikimi i buxhetit është bërë konform ligjeve në fuqi. Nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë të lidhura fshatrat me fshatra. Edhe nësi anëtarë të kuvendit nuk e kemi dhënë kontributin sa duhet, nuk kemi qenë aktiv në dëgjime publike buxhetore. Ne si grup e përkrahim.

Lumturie Bytyqi-Hasani, uroj që ky buxhet të jetë bërë karshi kërkesave të qytetarëve, unë e kam një pyetje për fshatin Shalë qytetarët kanë problem me ujë e pijës komuna a do ta rregullojë këtë qështje. Banorët e fshatit Shalë me sa jam unë në dijeni i janë drejtuar komunës me disa kërkesa për rregullimin e rrethojave të shkollës dhe nyjetë sanitare.

Imri Ahmeti, në Shalë ka pas debat kan marrë pjesë disa qytatarë ka pas kërkesa të ndryshme. Ne e kemi një fushë të vogël të futbollit të shkollë, një fushë të hapur, rrethojat e shkollës kanalizimin si edhe ndriqimin publik.

Ndërsa sa i përket rrugës “Mbretresha Teutë” jo vetëm te kjo rrugë por edhe te rruga “Avdi Avdiu” kemi problemin e shpronësimit.

Megjithatë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 votat për, 11 kundër, 1 apstenim aprovoi këtë:

## **VENDIM** **MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2019-2021**

### **Neni 1.**

Me këtë Vendim aprovohet Buxheti për vitet 2019-2021 për Komunën e Lipjanit.

### **Neni 2.**

Buxheti për vitet 2019-2021 do të financohet:

| <b>FONDI BURIMOR</b>             | <b>VITI 2019</b>     | <b>VITI 2020</b>     | <b>VITI 2021</b>     |
|----------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| Grant i Përgjithshëm             | 5,510,543.00         | 5,999,798.00         | 6,381,905.00         |
| Grant Specifik i Arsimit         | 6,345,854.00         | 6,375,328.00         | 6,404,954.00         |
| Grant Specifik i Shëndetësisë    | 1,728,150.00         | 1,814,558.00         | 1,905,285.00         |
| Të hyrat vetanake                | 1,983,269.00         | 2,051,658.00         | 2,120,046.00         |
| Financimi Shërbimet Rezedenciale | 160,000.00           | 160,000.00           | 160,000.00           |
| Huamarrje në Arsim               | 30,903.00            | 0                    | 0                    |
| Huamarrje në Shëndetësi          | 138,252.00           | 0                    | 0                    |
| <b>TOTALI</b>                    | <b>15,896,971.00</b> | <b>16,401,342.00</b> | <b>16,972,190.00</b> |

### **Neni 3.**

Mjetet nga neni 2. i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

| <b>KATEGORITE EKONOMIKE</b>   | <b>VITI 2019</b>     | <b>VITI 2020</b>     | <b>VITI 2021</b>     |
|-------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| Paga e Mëditje                | 9,280,000.00         | 9,280,000.00         | 9,280,000.00         |
| Mallra dhe Shërbime           | 1,470,000.00         | 1,410,001.00         | 1,419,999.00         |
| Shërbime Komunale (Komunalit) | 250,000.00           | 260,000.00           | 261,400.00           |
| Subvencione dhe Transfere     | 350,000.00           | 400,000.00           | 435,000.00           |
| Investime Kapitale            | 4,546,971.00         | 5,051,341.00         | 5,575,791.00         |
| <b>TOTALI</b>                 | <b>15,896,971.00</b> | <b>16,401,342.00</b> | <b>16,972,190.00</b> |

### **Neni 4.**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi pas publikimit në Web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.

### **Neni 6.**

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

**Shtesë:** Vendimi.

## V

### **Propozim vendim për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit për komunën mike për fëmijë (2018-2021)**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Vlorë Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMC, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Majlinda Sylejmani, më vjen mirë që Komuna e Lipjanit është ndër të parat që e promovon këtë Rregullore në veqanti në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, andaj ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Rregullore.

Shkelzen Bislimi, e falenderojmë organizatën “Polis” dhe drejtoratin e shëndetësisë për një plan të tillë. Nuk jemi kundër të drejtave të fëmijëve as kundër këtij plani por çka do të ndodh me ata të cilët i bëjnë 18 vjet dhe kanë përfunduar fakultete të cilët po dorëzohen për shkak të kushteve të rënda ekonomike.

Egzona Bytyqi, ne si grup parlamentar e përkrahim dhe shpresojmë që fëmijët të jenë zë i fuqishëm në të ardhmen. Shpresojmë që kjo strategji të zbatohet edhe në praktikë.

Safete Amerllahu, duke parë se fëmijët janë pjesa më e rëndësishme e jetës tonë, unë jam shumë e kënaqur me këtë propozim Rregullore dhe ne si grup e përkrahim.

Ukë Kryeziu, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim por shpresojmë që kjo nuk do të jetë vetëm në letër.

Lumturije Bytyqi-Hasani, sa i përket propozim Rregullores kam një propozim që të faqja 10 neni 1.8 ku është e shënuar shkolla të zëvendsohet me institucionet edukativo arsimore.

Anila Reçica, rasti të cilën u përmend më herët për largimin e një fëmije nga qerdhja nuk është i sakt pasi që unë vet pjesë e këtij institucione dhe kushtet të cilat i ka ofruar qerdhja nuk ju ka përshtatur prindit.

Vlorë Limani-Hajnuni, në këtë Rregullore bëhet fjalë për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare dhe këtë Rregullore nuk e ka bërë organizata “Polis” por është në bashkëpunim me komunën e Lipjanit ku ka punuar një ekip mjaft profesional prej lëmive të ndryshme. Pajtohemi që të zëvendësohet te neni 1.8 shkollat me institucionet edukativo arsimore.

Ramiz Qeriqi, unë nuk e kam fy kërkan, e kam kritikuar qeverisjen e keqe të juve ku kam thënë se aty keni marrë një kimiste është dashtë të jetë një pedagoge jo një kimiste dhe të jetë dikush që e din çka është bashkësia familjare çka është fëmija.

Albulena Kelmendi, ne si grup parlamentar e përkrahim Rregulloren që ka të bëjë me mbrojtjen dhe mos cenimin e të drejtave të fëmijëve dhe jemi të gatshëm të ndihmojmë në këtë aspekt.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimin që në faqen 10 neni 1.8 të zëvendësohet shkolla me institucionet edukativo arsimore dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 votat për, aprovoi këtë:

## **VENDIM**

### **PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR KOMUNËN MIKE PËR FËMIJË (2018-2021)**

#### **Neni 1**

**MIRATOHET**, Strategjia dhe plani i veprimit për Komunën mike për fëmijë (2018-2021).

#### **Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia dhe Plani i veprimit për Komunën mike për fëmijë (2018-2021).

### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në bashkëpunim me Drejtoratet kompetente komunale.

### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

**Shtesë:** Vendimi.

## **VI**

### **Propozim vendim për ndërrimin e destinimit të tokë**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Emina Rexhiqit , drejtoresh e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për, aprovoi këtë:

## **V E N D I M**

### **PER NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS**

#### **Neni 1**

**I.** Miratohet Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

#### **Neni 2**

**II.** Sipas pikës I të këtij Vendimi, toka me destinim bujqësor, parcela kadastrale P-71409001-00439-0 mwe kulturë livadh I klases së pestë ne sipërfaqe prej 5010m<sup>2</sup>, të evidentuar në certifikatën mbi të drejta e pronës së paluajtshme Nr.2276/2018 Zona Kadastrale Hanroc me të drejta posedimi individual të “Qendra për Trajtimin e Kafshëve” Sh.p.k. me numër biznesi Nr.71127168, përfaqësuar nga Lis Kabashi Drejtor- Agjent I regjistruar me seli ne Hanroc Komuna e Lipjanit, destinohet ne tokë ndërtimore.

#### **Neni 3**

Parcela kadastrale si toke bujqësore të cekura ne piken II të këtij Vendimi ne Planin Zhvillimor Komunal 15Nr.12514 dt.23.08.2013 përcaktohet si tokë ndërtimore, dhe të njëjtat do të jenë pjesë e procesit të vlerësimit dhe hartimit të Planit zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës.

#### **Neni 4**

Kompenzimin për ndërrimin e destinimit të tokës të cekur ne nenin 2 të këtij Vendimi do të paguhet ne procedure administrative të marrjes së lejes së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14 paragrafi 14.2. pika a dhe b të Udhëzimit administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

#### **Neni 5**

Obligohet investitori që implementimin e këtij Vendimi ta realizoj ne afat prej dy viteve nga dita e hyrjes ne fuqi të këtij Vendimi që nënkupton zhvillimet procedurale sipas nenit 2 dhe nenit 4, në të kundërtën nese brenda afatit prej 2 viteve nuk i perfundon procedurat e parapara sipas këtij Vendimi, ky Vendim do të shfuqizohet dhe nuk do të ketë fuqi juridike .

## **Neni 6**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorati për planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, drejtorati për Zhvillim Ekonomik si Organet tjera të Administratës komunale do t'i kryejnë veprimet përkatëse nga përgjegjësitë e tyre me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi.

## **Neni 7**

Ky Vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L- 040 dhe publikimi në web-faqen Zyrtare të Komunës.

**Shtesë:** Vendimi.

## **VII**

### **Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BIK në Lipjan**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në mungesë të drejtorit Bakim Shabani i dha fjalën Avni Ollurit, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, tha kjo pikë që po na vjen shpesh edhe në KPF e kemi trajtu për mua është interesante kjo shifër që nuk po ndryshon, herën e kaluar ishte 84 e tash 85 trendi mortalitetit nuk po ndryshon dhe është mirë që nuk po ndryshon. Ne jemi për këtë pikë me votu pasi duhet të kryhet shërbimi i varrimit. Dhe me padurim po e pres krijimin e këtij komisioni që do të merret me këtë Rregullore.

Ramiz Qeriqi, edhe unë jam për si parafolësja me u bë një Rregullore por jo vetëm për BI, por edhe për katolikët.

Afrim Miftari, edhe ne jemi pro kësaj pike të kaloj por për mua është shqetësuese numri i rasteve të vdekjeve nuk e di se a merret dikush, ndonjë institucion komunal me regjistrimin e lindjeve dhe vdekjeve.

Arben Salihu, duke marrur parasysh këtë procedurë deri sa të hynë në fuqi Rregullorja e ardhshme kalo 2-3 muaj, pasi është bërë rutin kjo punë unë kisha propozu që me kalu komplet në zyrën e Kryetarit ndoshta do të ishte më e lehtë edhe për neve edhe për Bashkësinë Islame. Nganjëherë po ndodh alokimi i mjeteve po vonohet dhe shpenzimi i shërbimeve po bëhet nga parat e veta për blerjen e materialeve. Po ashtu po shkakton probleme të pagat e punëtorëve të Bashkësisë Islame.

Avni Olluri, tha se aty janë të përfshira të gjitha kompenzionet fetare dhe shërbimin do ta marrin përmes kompanisë për rastet e vdekjes, kjo qështje do të vijë shumë shpejt në Kuvend për diskutim dhe do të marrim vendim për këtë qështje.

Megjithatë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 votat për, aprovoi këtë:

## **V E N D I M**

### **PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN**

## **Neni 1**

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **9350 €**, (nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë euro),

për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 85 raste të vdekjes, me nga 110 Euro për secilin rast  $110 \times 85 = 9350$ .

## **Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës .

## **Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

**Shtesë:** Vendimi.

## **VIII**

### **Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete.**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se kjo pikë e rendit të ditës është për zgjedhjen e një anëtarit të Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit serb pasi që Kryesuesi i Komitetit për Komunitete Boban Jovanović ka dhënë dorheqje për arsye personale ne kemi këtu dy emra por ka qenë një kërkesë në KPF që këta të dakordohen dhe të vijë me një propozim, vetëm me një emër por po ju lë grupeve parlamentare që të vendosni.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, tha se këtu i kemi dy emra me nga katër rreshta, është një CV e varfër dhe është mirë me marrë ma seriozisht këtë punë së paku me pasur një CV të dinjitetëshme. Unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme.

Hyra Bytyçi, edhe ne propozojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme dhe të vijë vetëm me një propozim dhe me një biografi më të pasur.

Ukë Kryeziu, edhe ne sikurse parafolësit jemi pro që kjo pikë të shtyhet për një seancë të ardhshme dhe të kenë një civi më të pasur.

Afrim Miftari, edhe ne si grup parlamentar propozojmë që kjo pikë të shtyhet dhe mundësisht ta kemi një pasqyrë më të detajuar.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi pyeti anëtarët se kush është që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 votat për vendosi që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme,

Pasi çë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16,<sup>00</sup>

**Ekstraktin e hartoi**  
**Rrahim Krasniqi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Daut Azemi**